



Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

-SEKRETARIATI I PËRGJITHSHËM-

Në bazë të nenit 7 të Vendimit për formimin e Këshillit për bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe shoqërisë civile ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 98/16 dhe 164/17 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 97/19 dhe 116/21), Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut publikon

**RAPORT PËR ORGANIZATAT E PARAQITURA ME KANDIDATË dhe THIRRJE
PUBLIKE PËR VOTIM**
**për zgjedhjen e 2 anëtarëve të Këshillit për bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe shoqërisë civile
nga radhët e shoqatave dhe fondacioneve për fushën e Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe
Integritet dhe politikat e BE-së**

I. RAPORT PËR ORGANIZATAT E PARAQITURA ME KANDIDATË

Në bazë të Thirrjes Publike për zgjedhjen e 2 anëtarëve të Këshillit për bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe shoqërisë civile nga radhët e shoqatave dhe fondacioneve për fushën e Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe Integritet dhe politikat e BE-së, publikuarmë 7.7.2021, në faqet e internetit www.nvosorabotka.gov.mk, në afatin e paraparë (21.7.2021) kanë arritur fletëparaqitje për 3 kandidatë.

Gjatë verifikimit administrativ të fletëparaqitjeve u përcaktua se fletëparaqitjet i Shoqatës për Zhvillimin e Shoqërisë -Inovacioneve Sociale VAKE UP - Shkup nuk i plotëson kërkesat e Thirrjes Publike, organizata nuk është e regjistruar në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Shoqatat dhe Fondacionet të paktën tre vjet para shpalljes.

II. THIRRJE PUBLIKE PËR VOTIM
**për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit për bashkëpunim me dhe zhvillim të sektorit
civil nga radhët e shoqatave dhe fondacioneve**

Thirren të gjitha organizatat aktive të regjistruara në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet. të japin votën e tyre vetëm për një kandidat, në fushën që është identike me fushën e veprimtë organizatës, në përputhje me statutin e saj.

Organizatat nuk votojnë për kandidatin nga organizata e tyre.

Votimi kryhet duke plotësuar **Formularin e Votimit**, të disponueshëm në lidhjen vijuese www.nvosorabotka.gov.mk dhe duke dorëzuar ekzemplar të **gjendjes aktuale** nga regjistrimi në regjistrin e personave të tjerë juridikë për regjistrimin e organizatës.

Sindikatat e regjistruara në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqatat dhe Fondacionet plotësojnë një formular votimi, që llogaritet për një votë të dhënë.

Organizatata mund të mbështesin vetëm një kandidat nga **Lista e Kandidatëve** në vijim.

Numri	Emri dhe mbiemri i kandidatit	Emri i shoqatës/ fondacionit që propozon kandidat	Biografia dhe letër motivimi
14. Mbrojtje e mjedisit jetësor			
32-43/4	Sllagjana Stamenkova	Shoqata e Qytetarëve për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor EKOZVON Shkup	
16. Politikat e BE-së dhe integritet			
32-43/2	Ardita Abazi Imeri	Instituti për Politikë Evropiane Shkup	

Për vota të pavlefshme do të llogariten votat e organizatave që nuk janë **aktive** në përputhje me gjendjen aktuale nga regjistrimi në regjistrin e personave të tjerë juridikë për regjistrimin e organizatës, si dhe votat e organizatave që kanë votuar në fushën e veprimtimit që nuk është paraparë në statutin e tyre.

Organizatata që realizuan të drejtën e tyre për të votuar në periudhën prej 14 deri më 29.04.2021 ose prej 7 deri më 21.07.2021 dhe vota e tyre u konsiderua e vlefshme, nuk kanë të drejtë të votojnë përsëri.

Afati i votimit është deri më 11.08.2021.

Formulari i plotësuar i votimit i nënshkruar nga përfaqësuesi i organizatës dhe i verifikuar me vulën e saj, me ekzemplar të **gjendjes aktuale** nga regjistrimi në regjistrin e personave të tjerë juridikë për regjistrimin e organizatës, duhet të dorëzohen përmes postës në adresën:

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Sekretariati i Përgjithshëm
Njësia për bashkëpunim me organizatat joqeveritare
bul. "Ilinden" nr.2
1000 Shkup

me shënimin: "Mbështetje për kandidat për anëtar të Këshillit".
ose **të skanuara** të dorëzohen në mënyrë elektronike në adresën: nvosorabotka@gs.gov.mk.

Në afat prej 8 ditëve pas përfundimit të votimit, Sekretariati i Përgjithshëm - Njësia për bashkëpunim me organizatat joqeveritare në faqen e internetit www.nvosorabotka.gov.mk do të publikojë Listën e kandidatëve sipas numrit të votave të marra për secilën nga fushat e veprimtimit.

